



ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

Komente dhe rekomandime lidhur me Projektligjin për çmime të produkteve medicinale

Neni 4 paragrafi 1, np.4 – atc kodi

- Të hiqet si përkufizim pasi nuk është përdorur në ligj askund.

Neni 4 paragrafi 1, np.10. Çmimi CIP është çmimi i cili përfshin transportin dhe sigurimin e paguar, deri në terminalin doganor

- Të shtohet në fund ... apo deri në vendin e destinimit sipas marrëveshjes.

Neni 5: paragrafi 1 np 1.2 dhe 1.4 të hiqen pasi janë të panevojshëm.

Neni 7 paragrafi 2: Formularët të përcaktohen nga komisioni. (këta mund të ndryshojnë nga viti në vit dhe në mënyrë që të mos paraqitet nevoja për ndryshimin e Ligjit atëherë të mbetet detyrë e komisionit.

Neni 7 paragrafi 4 dhe 5 – sipas procedurave të parapara me aktin nënligjor

- Të vensoset sipas procedurave të rregullore të komisionit

Neni 7 paragrafi 6 – riformulim pak më i saktë:

- Për rastet e produkteve medicinale të cilat nuk posedojnë autorizim për marketing, por të cilat do të autorizohen për tregtim/importim sipas akteve ligjore në fuqi procedura e deklarimit të çmimit bëhet sipas vendimit të Komisionit dhe përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 8 paragrafi 3:

- Malta nuk i ka të publikuara çmimet e produkteve medicinale – rekomandohet të ndërrohet me ndonjë shtet tjetër psh Çekia e cila njihet për çmime të ulëta në nivel evropian si dhe ka databazën shtetërore publike të çmimeve, apo edhe me ndonjë shtet tjetër.

Neni 9 paragrafi 3: të riformulohet pak më saktë:

- ... Megjithatë, produktet me lirim të modifikuar nuk mund të barazohen me forma me lirim të menjëhershëm.

Neni 9 paragrafi 4: të riformulohet më saktë:

- Së pari, do të llogaritet çmimi i referencës për njësi të produktit medicinal referent dhe pastaj shumëzohet me numrin e njësive të produktit medicinal që ka aplikuar.

Neni 9 paragrafi 5: të riformulohet pak më saktë e cila nuk përbën ndryshim thelbësor:

- Kalkulimi i çmimit do të ishte më i saktë nëse merren parasysh shumë se dy vende referentë, psh 3. Dhe kjo eliminon mundësinë që një shtet i katërt edhe po të ketë çmim shumë më të lartë ai nuk merret parasysh.

Neni 9 paragrafi 11 dhe 12:

- Duke marrë parasysh mesataret e marzhave me shumicë nga shtetet e rajonit (Shqipëria 11, Kroacia e përshkallëzuar fillon me 10%) dhe gjithashtu duke qenë se sipas këtij Ligji po vendoset një tavan për cmimin maksimal me shumicë si dhe cmimin e lejes se importit që kap vlerën 1%, pagesa për banderola, mungesën e depove doganore (të cilat shpesh paraqesin kosto shtesë për qëndrimin e barnave në terminale), prandaj rekomandojmë që kjo përqindje duhet të rritet në 10 apo 11%. Përsëri duke konsideruar se kjo përqindje nuk ndikon në tejkalimin e tavanit të përcaktuar të çmimit me shumicë por krijon një mbrojtje për distributorët në Kosovë.

Neni 10: çmimi i origjinatorit:

- Propozojmë që kjo të jetë si në Shqipëri të paktën 80% pasi edhe ashtu janë vendosur mjaft filtra për mbrojtjen e çmimit.

Neni 11 paragrafi 4 np.1 - Çmimi me shumicë i produktit nga € 0 – 9.99 € - marzha prej 20%;

- Cmimet nën një euro janë cmime të cilat kapin edhe çmime shumë të ulëta. Prandaj në raste të tilla bëhet barazimi i çmimit. Dhe prandaj në shumë shtetet çmimet e ulëta ndahen si kategori e veçante. Dhe në këto raste prandaj edhe ka qenë propozimi fillestar prej 35% sepse nuk paraqet ndikim significant në çmimin final.
- Pjesa tjetër e marzhave të përcaktuara janë shumë të ulëta krahasuar me shtetet e rajonit apo edhe BE duke i përcaktuar si më të ulëtat, pa marrë parasysh që edhe tregu është ekstremisht më i ulëti (Kroacia ka psh €1.3 bilion apo Serbia €833 milion etj)
- Në këtë rast konsiderojmë se është jetike se duhet të kthehen propozimet e para që kanë qenë për marzhat apo të përcaktohet një marzhë fikse e cila do të merrej si një mesatare prej 25% apo 30% (Shqipëria 25%, Kroacia 30%, Turqia 25% etj).

Neni 12 - Përcaktimi i çmimit më pakicë për barnat gjenerikë bëhet sipas nenit 11.

- I paqartë

Neni 13 paragrafi 2 - Komisioni për çmime të produkteve medicinale:

- Mungesa e përfaqësuesit të OFK është në kundërshtim me Ligjin për OPSH. Neni 10, parag 1, nënparagrafi 1.8 përcakton si kompetencë të odave “bashkëpunimi në përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale në bashkëpunim me institucionet tjera përgjegjëse;”
- Gjithashtu anëtari nga doganat është i panevojshëm.
- Konsiderojmë se ky nen duhet të analizohet me kujdes dhe të vendoset anëtari nga OFK.
-

Neni 14 paragrafi 2:

- Të theksohet se a flitet për produkt individual. Ose nëse flitet për substancë dhe që në mesin e atyre substancave kjo të diskutohet.
- Sido që të jetë duhet të precizohet më mirë pasi ka dykuptimësi.

Neni 15 Mbikëqyrja

- Cili është roli i ATK inspektimeve?
- Te definohet kjo pjesë që mund të ndërlidhet me evazionin fiskal.

Tjetër: të vendoset një nen i cili e përcakton se si do të vepohet me stoqet aktuale të cilat ndodhen në barnatore dhe depo farmaceutike.